



GERDI PAPA

PHD. ARK.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Gerdi Papa është lektor dhe përgjegjës i departamentit të Industrive Kreative në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Arkitekturë, Dizajn Komputacional, Automatizim

EMAIL

creat.dep@umb.edu.al

BIO

PhD. Ark Gerdi Papa është drejtues i Creative Maker Space Lab + Fab Lab, asistent në projektin Creative Europe [LINA] dhe i angazhuar në diplomat e Msc. në Arkitekturë. Gjithashtu, ai mbulon rolin e koordinatorit në "Forumet e Hapura - Arte të Aplikuara dhe Dizajn" si dhe në nivel departamenti i projekteve Erasmus+.

Lindur në Tiranë më 9 Nëntor 1989, Gerdi është një arkitekt i apasionuar pas dizajnit kompjuterik algoritmik si dhe në fabrikimin dhe prototipizim dixhital. Ai përfundoi studimet master në Arkitekturë dhe Dizajn Urban në Universitetin Polis në 2014 dhe Masterin Profesional në Dizajn Arkitekturor Parametrik në Universitetin Polis në vitin 2016. Merr titullin doktor i shkencave në Arkitekturë dhe Planifikim Urban nga Universiteti Polis dhe Universiteti i Ferrarës (Itali) në vitin 2020. Gjatë eksperiencës si pedagog dhe studiues në Universitetin Polis ai mbajti pozicionin e lektorit dhe hulumtuesit, duke kontribuar në krijimin dhe koordinimin e Labororit "Fabrica", koordinimin e masterit në Dizajn Arkitektonik Parametrik, hartimin dhe liçensimin e Masterit të Avancuar Profesional në Arkitekturën Digjitale dhe si zëvendës në Departamentit e Kërkimit në Arkitekturë, Dizajn dhe Inxhinieri si pjesë e njësisë kërkimore "Innovation Factory". Ai ka asistuar gjithashtu pranë Labororit të Kërkimit "Advanced Ceramics R&D Lab" dhe pranë qendrës IDEGUI në Guimarães (Portugali) në kuadër të shkëmbimit ndërkombëtar dhe angazhimit të tij në Universitetin Minho (Portugali), për realizimin e një punëtorie me ndërtimtari me bamboo.